



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 171 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
Nr. 991 Prot.

AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili më poshtë do të quhet **ZQRPP**, i përfaqësuar nga Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme, z. Artan Gjylbegaj.

Kjo akt-marrëveshje lidhet në bazë të nenit 17 e 26 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë" dhe të nenit 3 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Qëllimi i kësaj marrëveshje është:

realizimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritja e efikasitetit dhe bashkërendimit të punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

Palët në marrëveshje bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. ZQRPP nëpërmjet Zyrave të Regjistrimit në rrethe, do të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive cdo informacion që disponon, në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë së paluajtshme.

3. ZQRPP do të autorizojë një sektor për një komunikim dhe shkëmbim të të dhënave sa më të shpejtë, konkret dhe të efektshëm.

4. Kërkesa për marrje informacioni do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. ZQRPP merr përsipër që, jo më vonë dhe 5 ditë nga marrja e kërkesës, të kërkojë informacion nga Zyrat vendore dhe pas marrjes së tij, brenda 10 ditëve t'i përgjigjet zyrtarisht për informacionin e kërkuar personit të autorizuar nga ILDKP.

5. Kërkesa për marrje informacioni nga ILDKP-ja duhet të ketë të dhëna të plota dhe të sakta lidhur me identitetin e plotë të personit, të dhënat mbi pasuritë, si dhe informacione të tjera plotësuese për Identifikimin e pasurisë së paluajtshme.

6. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



**ZYRA QENDRORE E
REGJISTRIMIT PASURIVE
TË PALUAJTSHME**

Kryeregjistruesi

ARTAN GJYLBEGAJ

